



International
Labour
Organization



Keshilli i Qarkut Kukes



Empowered lives.
Resilient nations.

Projekti "Përgjigjet në nivel lokal ndaj sfidës së punësimit të të rinjve në Shqipëri"

Thirrje për shprehje interesi

Shërbime trajnimi në lidhje me kultivimin dhe grumbullimin e BMA-ve dhe sipërmarrjen në rajonin e Kukësit

I. Historiku dhe arsyet themelore

Projekti i financuar nga SDC (Agjensia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim) në lidhje me Përgjigjet në Nivel Lokal për Sfidën e Punësimit të të Rinjve e njihet rolin kyç që autoritetet rajonale\lokale si edhe masat e ndërmarra nga institucionet qendrore mund të luajnë në trajtimin e sfidave të tregjeve lokale të punës. Bazuar në eksperiencën e mëparshme në kuadrin e Projektit të Përbashkët të OKB për Punësimin dhe Migrimin e të Rinjve (PMR), kjo ndërhyrje synon konsolidimin dhe zgjerimin e përfshirjes së komuniteteve lokale në përpjekjet për zgjidhjen e problemeve të papunësisë. Paktet Territoriale të Punësimit (PTP) përfaqësojnë një risi institucionale e cila është e bazuar në konsultime dhe në planifikim të negociuar midis aktorëve publikë dhe privatë në nivel kombëtar dhe lokal, aktorë të cilët bashkohen për hartimin e objektivave të punësimit duke e vënë theksin tek formalizimi i punëtorëve të rinj dhe krijimi i vendeve të punës.

Paktet projektohen si partneritete nga poshtë-lart me qëllim që të nxisin iniciativat dhe skemat që e trajtojnë papunësinë që në rrënjë. Në të njëjtën kohë masat e PTP-së mbështesin politikat të cilat shënjestrojnë zhvillimin dhe formalizimin e sektorit të bujqësisë duke promovuar formalizimin e ndërmarrjeve shumë të vogla (mikro), veçanërisht në zonat e thella.

Ngritja dhe funksionimi i Bordeve Rajonale të Punësimit, të cilët institucionalizojnë rrjetet e aktorëve lokalë, e rrit besimin në lidhje me mundësinë e përsëritshmërisë së këtij modeli përtej kohëzgjatjes së projektit. PTP-të, si instrumente politike efikase të cilët mund të katalizojnë lloje të reja bashkëpunimi dhe veprimi, janë replikuar edhe në rajonet e Kukësit dhe Shkodrës dhe tani po testohen për herë të parë në rajonin e Lezhës. Gama e rezultateve dhe e mësimave të nxjerra mund të vazhdojë në territoret e përfshira në Pakt edhe përtej periudhës së mbështetjes nga projekti (dmth mund të jetë i qëndrueshëm) dhe gjithashtu mund të jetë i rëndësishëm edhe për aktorë të tjerë të cilët po përpiqen të

kryejnë ndërhyrje të të njëjtit lloj (shpërndarja) apo të formulojnë përgjigje për politikën (përfshirja), ose të dyja.

II. Përshkrimi i shërbimeve

Shqipëria është lojtar kryesor ndërkombëtar për produkte si psh sherbela, trumza, rigoni dhe erëzat dimërore. Në tregje të zgjedhura produktet shqiptare janë udhëheqëse si për shembull në rastin e sherbelës në Amerikë dhe në rastin e trumzës në Gjermani.

Shumica e tregtisë së BMA-ve është me produkte organike. Kostoja në rritje e prokurimit, konkurrenca midis tregtarëve me shumicë dhe vështirësia për të bërë përputhjen e potencialit të tregut me produkte organike në mënyrë ekskluzive kanë rritur interesin e operatorëve për kultivimin e bimëve të tilla si: sherbela, rigoni, trumza e butë dhe mustaqet e misrit.

Përprojekjet aktuale për zgjerim janë të përqëndruara tek zgjerimi i gamës së BMA-ve organike, dhe tek investimi për përpunimin e BMA-ve për të bërë të mundur prodhimin e vajrave esenciale. Në përgjithësi, sherbela e rajoneve veriore konsiderohet e një cilësie më të mirë, ndërsa për sa i përket rignonit dhe trumzës zonat qendrore dhe jugore ofrojnë një cilësi superiore.

Për realizimin e objektivit të kësaj ndërhyrje do të kryhen aktivitetet e mëposhtme:

1. Identifikimi dhe përzgjedhja e 10 fermerëve të rinj (femra/meshkuj) nga mosha 15-29 vjeç, të cilët janë pronarë toke dhe të gatshëm për kultivimin e BMA-ve.
2. Ofrimi i trajnimit për 10 të rinjtë fermerë të identifikuar në lidhje me kultivimin, ruajtjen, magazinimin dhe tharjen e BMA-ve. Trajnimi teknik (si në klasë ashtu edhe në vendin e punës) do të plotësohet edhe me trajnim për sipërmarrje.
3. Të rinjtë e trajnuar do të inkurajohen që të regjistrohen si të vetë-punësuar. Secilit pjesëmarrës të përzgjedhur do t'i ofrohet një grant prej 1,300 dollarësh për regjistrimin ligjor dhe fillimin e aktivitetit të biznesit.

III. Detyrat kryesore dhe produktet e pritshme

Ofruesi i trajnimit në këtë prokurim ka për detyrë:

- a. Të ofrojë trajnim (si në klasë ashtu edhe në vendin e punës) për 10 të rinj të zonës në lidhje me kultivimin, ruajtjen, magazinimin dhe tharjen e BMA-ve si edhe në lidhje me sipërmarrjen. Pjesëmarrësit në trajnim do të përzgjidhen nëpërmjet një Thirrje të veçantë për Aplikime.
- b. Kontraktuesi do të ofrojë asistencë për të dhjetë fermerët e trajnuar për sa i përket regjistrimit të tyre si të vetëpunësuar.

IV. Aktiviteti dhe afati kohor

Aktivitetet e kësaj detyre pritet të fillojnë brenda muajit **mars 2014 dhe do të përfundojnë deri në fund të muajit qershor 2014.**

Duke kryer aktivitetet e lart-përmendura, ofruesi do të jetë përgjegjës për produktet e mëposhtme, të cilat përbëjnë edhe etapat kryesore:

Aktiviteti	Afati kohor
Përgatitja e materialeve të trajnimit;	Deri në 15 mars 2014
Trajnim në lidhje me kultivimin, ruajtjen dhe tharjen e BMA-ve;	Mars-Prill 2014
Trajnim mbi sipërmarrjen, duke përfshirë përgatitjen e planit të biznesit;	Deri në datën 30 prill, 2014
Asistencë për regjistrimin e të dhjetë të rinjve fermerë si të vetëpunësuar;	Deri në mesin e muajit maj 2014
Raporti përfundimtar.	Qershor, 2014

Të gjitha aktivitetet duhen diskutuar dhe dakordësuar me Organizatën Ndërkombëtare të Punës (ILO) si edhe dorëzuar në letër dhe formë elektronike në gjuhët shqip dhe anglisht.

V. Vlerësimi i performancës

Performanca e kontraktuesit do të vlerësohet në bazë të kriterëve të tilla si: respektimi i afteve kohor, përgjegjësia, inisiativa, komunikimi, saktësia dhe cilësia e produkteve.

VI. Planifikimet financiare

Shuma maksimale në dispozicion për këtë detyrë është 8,000 USD (tetë mijë).

Shuma e lart-përmendur është shumë e përgjithshme dhe mbulon të gjitha kostot që lidhen me detyrën e caktuar, duke përfshirë, por jo vetëm, i) kostot e seancave të trajnimit që do të organizohen, duke përfshirë dhe ambientin ku do të kryhet ky trajnim; ii) udhëtimet e nevojshme në terren (duke përfshirë sigurimin) dhe kostot e komunikimit të kompanisë.

Pagesa do të kryhet në tre këste në momentin e paraqitjes së aktivitetëve të kryera dhe aprovimit nga Koordinatori Kombëtar i Projektit ILO.

VII. Kërkesë

Kompanitë e interesuara që do të kontraktohen për kryerjen e detyrave të lart-përmendura duhen të kenë karakteristikat e mëposhtme:

- 1) Të jenë të regjistruara zyrtarisht si ndërmarrje/biznes;
- 2) Të mund të provojnë eksperiencën e tyre në fushën e trajnimit në lidhje me BMA-të;
- 3) Të mund të provojnë eksperiencën e tyre në trajnimet për sipërmarrjen;
- 4) Të kenë në dispozicion stafin e përshtatshëm mësimor.

Pagesa do të kryhet në tre këste në momentin e paraqitjes së aktivitetëve të kryera dhe aprovimit nga Koordinatori Kombëtar i Projektit ILO.

Pagesa e parë në masën 30% të shumës totale do të kryhet menjëherë pas nënshkrimit të Kontratës dhe pas marrjes së një kërkesë për pagesë dhe një fature para-pagimi nga Kontraktuesi.

Kësti i dytë në masën 40% të shumës totale do të paguhet pasi të dëshmohet se ka përfunduar trajnimi dhe formalizimi i vetë-punësimit, dhe pas marrjes së një raporti përshkrues në lidhje me detyrat e kryera dhe të llogarisë financiare për këstin e parë dhe faturën e lëshuar nga Kontraktuesi.

Kësti i fundit prej 30% do të paguhet menjëherë pas përfundimit të të gjitha aktiviteteve të planifikuara sipas Termave të Referencës të kontratës aktuale dhe pas marrjes së raportit përshkrues dhe të të gjithë dokumenteve mbështetëse, përfshirë këtu edhe llogarinë financiare dhe faturën.

.....

Nëse kompania juaj i plotëson kërkesat e caktuara dhe nëse dëshironi të kontribuoni në projektin e lart-përmendur, ju lutemi të paraqisni, **brenda dates 21 shkurt, 2014 në orën 16:00 në mesditë, në adresën e mëposhtme**, Shprehjen tuaj të Interesit, së bashku me i) Përshkrimin teknik të detyrave të zbatimit, duke përfshirë edhe afatet kohore; ii) Çertifikatën e subjektit ligjor; iii) Listën e eksperiencave të kompanisë në fushën së cilës i përket kjo detyrë; IV) CV-të e trajnerëve të ngarkuar për të kryer trajnimin. Ju lutemi të shkruani "*Shprehje interesi*" në krye të emailit/tek subjekti dhe t'i referoheni titullit të Termave të Referencës.

Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO) ruan të drejtën e pranimit ose refuzimit të çdo propozimi.

Z. Bukurosh Onuzi
Koordinatori Rajonal për Kukësin
Adresa: Këshilli i Qarkut Kukës
E-mail: buabon@yahoo.com
Cel: +355 69 20 96 645

Znj. Eni Kristo
Asistente e Projektit
Adresa: Zyra Qendrore e UNDP-se
E-mail: eni.kristo@undp.org
Cel: +355 69 20 66 123